



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.13, datë 27.02.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “STALLË PËR RITJEN E DHIVE”, ME VENDNDODHJE NË BËRDICË E MADHE, BASHKIA SHKODËR

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Chicken Land” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Stallë për rritjen e dhive”, me vendndodhje në Bërdicë e Madhe, Bashkia Shkodër, me zhvillues shoqërinë “Chicken Land” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) miratimit të vendimit të VNM-së (Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) përkatëse;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
BLEDI ÇUÇI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTORI AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
LEDIA TOTA

